

NDIKIMET MORFOSINTAKSORE TË HUAJA NË GJUHËN SHQIPE

Kohët e fundit, në vargun e gabimeve dhe shmangieve të palejueshme nga normat e shqipes standarde, po shtohen jo vetëm gabimet drejtshkrimore dhe fjalët e huaja të panevojshme, po edhe disa ndikime morfosintaksore të huaja që sjellin pështjellim dhe largim nga huret e shqipes. Këtë dukuri e shohim me shqetësim, prandaj mendojmë se është koha të përpiqemi të jemi bashkëkohorë në dijet që u japim shkollarëve, por këtë ta kryejmë pa rendur pas mënyrave të të thënit sipas gjuhëve të huaja, të lakmojmë sa më tepër shqipen e thjeshtë e të pastër, t'u largohemi frazave të stërzgjatura, të mbingarkuara dhe të papërpunuara nga ana sintaksore, të ruajmë sa më shumë etnografinë e të folurit shqip. Dijeve të reja që parashtrihen në tekstet shkollore, sado të ndërlikuara e të përditësuara me njohuritë bashkëkohore, që sjell domosdoshmëria e europianizimit dhe botërorizimit të shkollës shqiptare, t'u qasemi shqiptarisht, pa përfryrje e stërhollime të kota.

Do të ndalemi, sidomos, në disa prirje, që po bëhen më të dendura se norma dhe, në këto rrethana, po të vazhdojmë të heshtim edhe më tej, do të bëhemi bashkëfajtorë me ata që po i shkaktojnë dëm të madh gjuhës shqipe. Proceset e ndikimit të faktorëve shoqërorë në gjuhën e folur gjuhësia shqiptare i ka ndjekur fare pak, kryesisht në studimet dialektore, por jo edhe në hapësirat e tjera po aq të vlefshme për t'u njohur e marrë parasysh, kur është fjala për rrjedhat e sotme zhvillimore, qoftë brenda hapësirave mirëfilli shqiptare, qoftë edhe në kahun e shndërrimeve të mëtejshme rruzullimore a globalizuese. Mbi të gjitha, nuk mund ta fshehim se ka rënë disiplina gjuhësore e shtetit dhe kjo duket edhe në praktikën shkrimore e botuese të shkollave tona të larta. Ka gabime të panumërta e të pafalshme dhe në burokracinë shkollore: në regjistrat, amzat, diplomat,

dëshmitë etj. dhe, madje, deri në dokumentet zyrtare të dhënies së gradave e titujve më të lartë. P.sh.: *prof.* dhe *dr.*, shumëkush i shkruan me të madhe, ndërsa ato, kur nuk janë në fillim të rreshtit, duhet të shkruhen me shkronjë të vogël. Njësoj si z. për zotëri, *znj.* për zonjë etj. Edhe gjuha e botimeve shkollore ka pasur rënie të palejueshme të kujdesit për normën standarde.

Përvoja e derisotme, po të flasim “me dorë në zemër”, lë shumë për të dëshiruar. Jemi ende larg, ndoshta shumë larg, nga ajo që pritet dhe që kemi mundësi të bëjmë në gjuhën e terminologjinë e teksteve shkollore. Shembujt do t’i sjellim edhe nga tekste të gjuhës shqipe, sepse, për fat të keq, gabime dhe të meta të mëdha gjuhësore ndeshim jo vetëm në librat e lëndëve jogjuhësore, por edhe në librat e leximit e të gjuhës shqipe, të shkruar edhe nga autorë me përvojë të gjatë. Nuk mund të mos theksojmë, gjithashtu, rrethanën e pamirë se, ndonjëherë, edhe në librat që kanë autorë ose bashkautorë gjuhëtarë të njohur (përfshirë edhe librat “Gjuha shqipe”, 1, dhe “Letërsia dhe gjuha shqipe”, 2), janë përvjedhur deri edhe gabime të pafalshme, fjalë të shkruara në kundërshtim me rregullat e drejtshkrimit, trajta të gabuara morfologjike, kuptime të pasakta të fjalëve dhe termave, për të mos përmendur zgjedhjen jo të goditur të shembujve, formulimet e errëta të pyetjeve dhe të detyrave, si dhe përgjithësisht stilin e pazhdërvjellët të teksteve shkollore.

Konkurrenca e botimeve shkollore është shtuar, do të shtohet edhe më shumë në të ardhshmen, por ajo **duhet të jetë, në radhë të parë, konkurrencë cilësie**. Më mirë një libër të vetëm të shkruar mirë, sesa disa tekste “alternative” të shkruara keq, me gabime gjuhësore e pa përpunimin e nevojshëm. Parimi i shenjtë i shkollës duhet të jetë kurdoherë ai i popullit shqiptar që thotë: *Më mirë djepin thatë, sesa shejtanin brenda.*

Shpresoj se, sikundër e kam shprehur edhe para disa kohësh, në Tiranë, në tubimin përurues të *Projektit të korrigjimit kompjuterik*, më tej, kur të fillojmë ta zbatojmë në ballë të gjerë atë program, duke u çliruar së paku nga gabimet drejtshkrimore nëpërmjet korrigjimit automatik, autorët e teksteve shkollore, si dhe kushdo tjetër që punon në fushën e letrave shqiptare, do të kenë rastin dhe mundësinë të mendojnë më shumë për kuptimet e fjalëve, për qartësinë dhe bukurinë e thënies, si dhe

për të shkruar libra shkollorë me prurje e përpunim gjuhësor më të mirë se deri më sot. Me fjalë të tjera, duke përfitur nga korrigjimi kompjuterik i drejtshkrimit, të bëjmë një hop cilësor në kulturën e gjuhës së librave shkollorë. Ky hap, ta themi hapur, është bërë këto vitet e fundit më se i domosdoshëm. Librat e shkollës, në mjaft raste, kanë gjuhë të papërpunuar në shkallën e duhur, kanë fraza të gjata, ndonjëherë kilometrike dhe të tilla që nuk del i qartë kuptimi i lëndës, kanë varfëri e shtampëzim të shprehjes, si dhe mbartje të mënyrave të huaja të shprehjes ose kalkime të pamira e të papranueshme strukturore. P.sh., si mund të pranojmë të vëmë në dorë të nxënësve libra ose fletore pune ku kërkohet: “*Ha ushqime që ndihmojnë mosprishjen e dhëmbëve.*”(?!), “*Ju lutem, mund të më bëni një vizitë për dhëmbët?*”, “*Saktëso adresën pa gabime!*”, “*Përshkruaj për shokun, qytetin që të ka pëlqyer, duke u ndihmuar edhe nga fjalët: ...*” Shembuj të tillë dëshmojnë për punë të ngutur, të pakujdesshme dhe për mënyra të shkruari që ka ardhur koha t’u themi “Ndal!”.

Disa nga pikat ku duhet të tregojmë vëmendje më të madhe dhe kujdes të përqendruar në të gjitha tekstet shkollorë, sipas meje, do të ishin këto:

1. Të ruhem nga **gabime që burojnë nga modelimi i gabuar, që vjen kryesisht nga rendja pas kalkimeve strukturore prej gjuhëve të huaja** dhe që nuk shkojnë sipas natyrës e modeleve të shqipes. Në këtë mes, sikundër do të përpiqem ta sqaroj edhe me shembuj, **pikën më problematike e përbën keqpërdorimi i formave të trajtës së pashquar dhe i përemrave vetorë të vetës së parë** (*unë, ne*) e të dytë (*ti, ju*) para foljeve. Shqipja ka zgjedhim të foljeve duke marrë ato trajta të dallueshme vetore, prandaj nuk ka pse të përsërisim përemrat vetorë, kur mbaresa foljore është e vetëmjaftueshme për të treguar vetën. Madje, në shqipen e bukur, kumbon hijshëm folja që shoqërohet me pjesëzën *po*, pa përemrin vetor, si p.sh.: *po shkoj, po vij, po punonte, po mbillte, po fliste, po dëgjonte* etj.

Në shumë prej librave shkollorë, ashtu si në gjuhën e përkthimeve dhe të mediave, *po* bën udhë pa nevojë denduria e panevojshme e vetorëve **unë, ne, ju** para foljeve përkatëse, **sipas gjedhes dhe trysnisë së anglishtes dhe gjuhëve të tjera** ku format e njëjta foljore dallohen vetëm nga prania e përemrit:

p.sh., anglisht: *We are, They are*. Në shqipen, qoftë kur flasim, qoftë kur shkruajmë, nuk kemi pse të themi *unë jam, ti je* etj. (kur theksi logjik nuk bie mbi vetorin), sepse folja zgjedhohet dhe merr forma të ndryshme sipas vetave, gjë që e bën jo vetëm të panevojshëm, por edhe të tepërt e të panatyrshëm përdorimin e përemrit vetor. P.sh., në tekst thuhet: “**Unë** nuk gjeta asnjë vitaminë **tek** pjata ime”. (Duhej: **Nuk gjeta** asnjë vitaminë **në** **pjatën** time). Ose: “Kur **ju** kërkoni të luani me një lodër, që ju pëlqen, veproni” (Duhej: **Kur kërkoni** të luani me një lodër që ju pëlqen, çfarë bëni”.

2. Gati të gjitha tekstet shkollore që kemi marrë në shqyrtim për të nxjerrë shembujt, përfshirë edhe ato që kanë autorë ose bashkautorë gjuhëtarë profesionistë, kanë **tepri të papranueshme të një-së** joshqese, e cila, sipas nesh, gurrën e ka nga përkthimet prej gjuhëve të huaja, porse po **merr përmasa si modelim i “parapëlqyer” dhe ka rrezik të na dëmtojë hijeshinë dhe natyrën e shqipes**. Për të theksuar karakterin kushttrimues të kësaj dukurie, shembujt do t’i japim kryesisht nga libra që kanë autorë ose bashkautorë gjuhëtarë:

Në tekst thuhet: “Kush mbjell **një** pemë mendon për të ardhmen” (Mendoj se duhej: Kush **mbjell pemë**, mendon për të ardhmen.).

Në tekst thuhet: “Arti i të shkruarit është **një** proces vetjak që mësohet.” (Duhej: Arti i të shkruarit **është proces** vetjak që mësohet.).

“Hapni “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” në faqen 435. Aty do të gjeni fjalën **ese** të përkufizuar si **një** term që përdoret në letërsi.” (Duhej: Aty do të gjeni fjalën **ese** të përkufizuar **si term** që përdoret në letërsi.).

Në tekst thuhet: “Fjala vjen, **një** përmbledhje duhet ditur se si mund të jepet thelbësorja e **një** teksti, për **një** koment duhet të dish **ti** japësh domethënien horizontale dhe pingule të tij si dhe të gësh mjetet gjuhësore shprehëse për **një** diskutim duhet ditur se si bëhet paraqitja e fakteve, argumentimi, pohimi i një teze dhe kundërshtimi i saj.” (Duhej, së pari, të ishin mënjanuar edhe disa gabime drejtshkrimore, si **ti** (t’i) dhe të ishin vënë shenja pushimi (presje), por, më mirë, të ishte ndërtuar fraza me frymëmarrje të mirë, pra të ishte shkruar me fjali të ndara me pikë e pikëpresje.

Ndërkaq, disa prej **një**-ve joshquese nuk ka pse të përdoshin, sepse shkojnë kundër natyrës së shqipes).

Në tekst thuhet: "Një ndër përkufizimet e vlerëson lirikën (ose poezinë lirike) si **një** gjini poetike, e cila shpreh në mënyrë subjektive ndjenjat dhe emocionet e përfutuara, njëherësh, me **një** tingëllim të veçantë të fjalës dhe ritmin e kushtëzuar të vargut." (Duhej: Një ndër përkufizimet e vlerëson lirikën (ose poezinë lirike) si **gjini poetike**, e cila shpreh në mënyrë subjektive ndjenjat dhe emocionet e përfutuara, njëherësh, **me tingëllim të veçantë** të fjalës dhe ritëm të kushtëzuar të vargut).

Në tekst, disa rreshta më poshtë, thuhet: "... lirika monodike ose korale këndohej në mjedise më të ngushta festive ose familjare, nga **një** individ ose **një** grup koral, të udhëhequr nga **një** korife." (Duhej: ...lirika monodike ose korale këndohej në mjedise më të ngushta **familjare ose shoqërore**, nga **individë** ose **grupe korale**, të udhëhequr nga një drejtues, që **quhej korife**.).

Në tekst thuhet: "Xhorxh Bajroni..., poet anglez, ... pati **një** fëmijëri të palumtur për shkak të **një** defekti të lindur në njëren këmbë." (A thua se, një fëmijëri e pati të palumtur, kurse nja dy a tri të tjera i pati të lumtura (!?). Besojmë se, shqip, duhej thënë: "Xhorxh Bajroni..., poet anglez, ... **pati fëmijëri** të palumtur për shkak se kishte lindur me njëren këmbë të çalë." Fan Noli, i cili e dinte shqipen aq bukur dhe e shkruante aq hijshëm, në vjershën e tij "Plak topall dhe ashik" thotë "*dale moj se jam i çalë...*", nuk thotë: *dale moj se jam me një defekt të lindur në njëren këmbë(!?)*).

Në tekst thuhet: "Tregoji shokut **një** ngjarje me **një** fëmijë të huaj!" Mund të thuhej: Tregoj ndonjë ngjarje me të huaj, por jo duke e gozhduar fëmijën me dy **një**-sha njërin pas tjetrit.

Në tekst thuhet: "Pjetër Budi... ishte **një** intelektual me kulturë të gjerë..." (Shqip duhet të thuhet: ishte intelektual me kulturë).

Në tekst thuhet: "Naim Frashëri kishte **një** shpirt njerëzor emocionalisht të pasur e të trazuar, **një** botë të pasur intelektuale..." (a thua se, krahas tyre, kishte edhe disa të tjera, kur duhej thënë sipas natyrës së shqipes: "Naim Frashëri **kishte shpirt** njerëzor emocionalisht të pasur e të trazuar **dhe botë** të pasur intelektuale...")

Në tekst thuhet: "Pas ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të

Prizrenit...krijimtaria e Naim Frashërit merr **një** përmbajtje të thellë patriotike." (Duhej shkruar: Pas ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit...krijimtaria e Naim Frashërit **merr përmbajtje** të thellë patriotike.)

Në tekst thuhet: "Bëni **një** përshkrim të figurës së Don Kishotit ashtu siç ju shfaqet në këtë fragment...!" (Jo vetëm nga ana gramatikore, por edhe nga përmbajtja këtu duhej trajtë e shquar, pra duhej të thuhej: "**Bëni përshkrimin** e figurës së Don Kishotit siç ju shfaqet në këtë fragment...").

Në tekst thuhet: "Disa autorë nuk bëjnë **një** dallim të qartë mes tekstit si proces dhe tekstit si produkt." (Duhej: ... nuk **bëjnë dallim**).

Shkurt: *jap ndihmesë* (ose me fjalë të huaja: *jap kontribut*), si dhe shumë togfjalësha foljorë të tillë, shkojnë sipas natyrës së shqipes: **folje + emër në trajtë të pashquar, pa nyjën joshquese**, si: *ha bukë, pi ujë, bëj ballë, marr burrë, marr grua* etj.

3. Në librat e shkollës, ashtu si gjithandej në shqipen e shkruar, hasen edhe **ndërtime gramatikore të huaja**, që nuk i përshtaten natyrës së shqipes dhe janë fryt i përkthimit të keq nga gjuhët e huaja. P.sh., kohët e fundit, në shtyp dhe në emisionet e lajmeve të RTSh-së është përdorur kalku "nën pranga", p.sh., "*nën pranga kanë përfunduar...*". Shqip thuhet: *në pranga, me duar në pranga, i lidhur me pranga*. Pra, forma *nën pranga* duhet mënjeluar si ndikim i papërshtatshëm i italishtes "sotto le manete". Po kështu, përdoret gabimisht **nën kontroll** (p.sh., kaluan nën kontroll), nën ndikimin e italishtes "sotto controllo", kurse në shqip thuhet: *kaloj në kontroll* ose, edhe më mirë, vetëm me foljen *kontrolloj, bëj kontroll*. Të njëjtin kalk të panevojshëm nga italishtja e shohim edhe në raste si: **mbi skenë** (p. sh., *artistët interpretuan mbi skenë*), ndërsa në shqip thuhet *në skenë*. *Artistët dolën në skenë, interpretuan në skenë; shfaqja u vu në skenë*. Forma *mbi skenë* është shpërdorim sipas it. *sul palco scenico*. Një prirje e dëmshme është tepria e togjeve foljore të tipit *bëj + emër abstrakt*, si. p. sh., *bëj kapjen*, ndërsa në shqip mund të thuhet thjesht: *kapën* ose *zunë*. Më kot (dhe për shëmtim të dukshëm të shqipes) kanë filluar të përdoren format e foljeve në kohën e kryer në vend të së kryerës së thjeshtë: P.sh., "*Është kthyer në atdhe ekipi i X*". Shqip thuhet: *Sot u kthye, sot erdhi, sot u përurua* etj. Shqipja i dallon

shumë bukur format dhe kuptimet e kohës së kryer, prandaj nuk ka pse të përzihen ato aq keq siç po e shohim në shtyp e në kronikat e Radio-Televizionit. Edhe kjo, sipas vëzhgimeve tona, është formë që vjen si ndikim nga italishtja dhe gjuhët e tjera ku format e së kryerës së thjeshtë janë rralluar ose edhe nuk përdoren fare.

4. Në librat e letërsisë, sidomos të atyre që janë botuar këto vitet e fundit në Tiranë, nuk dimë pse është bërë “modë” të thuhet se x shkrimtar “u lind”, në vend të formës tashmë të rrënjosur e të mirëqenë **lindi**. P.sh. në librin “Letërsia dhe gjuha shqipe”, 2, ShBLSH e Re, Tiranë, 2005, thuhet gati sistematikisht: **u lind** në vend të **lindi**: “*Naim Frashëri (1846-1900) u lind në Frashër...*” (f. 55), “*Lazgush Poradeci... u lind në Pogradec...*” (f. 66), “*Migjeni... u lind në Shkodër...*” (f. 69), “*Martin Camaj u lind në Temal të Dukagjinit...*” (f. 769), “*Dritëro Agolli u lind në Menkulas të Devollit...*” (f. 81) etj.

Këto, dhe të tjera, janë gabime që duhen shmangur nga librat e shkollës. Natyrisht, shembujt që u sollën nuk janë të vetmit dhe as të zgjedhur për të nënvlerësuar ose për të errësuar punën e mirë që është bërë nga shumë autorë tekstesh për të ardhur deri në atë nivel që i kemi sot librat shkollorë. Qëllimi dhe mëtimi ynë krejt i çiltër është vetëm dashamirës dhe i tillë që, **duke parë se kjo dukuri po shpie në dëmtimin e strukturës së shqipes**, shqetësimi ynë i ligjshëm është t’u vlejnjë autorëve për ripunimin e librave ekzistues ose gjatë hartimit të teksteve të reja, duke i paralajmëruar të gjithë (përfshirë edhe veten time) të tregojmë kujdes të posaçëm dhe të mos e lëshojmë dorën në prurje dhe kalkime të huaja të panevojshme.

Literaturë mbështetëse:

1. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.
2. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1976.
3. Strunk Wiliam, Jr, *The Elements of Style*, New York, 1918. “Lajmim”, botuar në gazetën “Përlindja e Shqipëniës”, Viti I, nr. 6,17/30 gusht 1913.